



: albansk
Informasjon til asylsøkere i Norge



INFORMACIONE

PËR AZILKËRKUESIT NË NORVEGJI

Kjo broshurë është përpiluar nga Organizata Norvegjeze për Azilkërkuesit (NOAS).

NOAS është një organizatë jo-qeveritare për të drejtat e njeriut që iu ofron informacione dhe ndihmë juridike personave që kërkojnë azil.

Broshura përmban informacione me rëndësi për azilkërkuesit të cilët bëjnë kërkesë për mbrojtje në Norvegji.

KËTU GJENI PËRGJIGJE PËR ÇËSHTJE SI:

- Kush ka të drejtë për mbrojtje?
- Kush mund të marrë leje qëndrimi për arsye humanitare?
- Cili shtet do ta shqyrtojë kërkesën tuaj për azil?
- Kush do të shqyrtojë në Norvegji kërkesën tuaj për azil?
- Çfarë ndodh kur bëni kërkesë për mbrojtje?
- Këshilla të rëndësishme për intervistën e azilit
- Detyrimet dhe të drejtat tuaja si azilkërkues
- Detyrimi për mbajtjen e sekretit profesional

1. KUSH KA TË DREJTË PËR MBROJTJE?

Keni të drejtë për mbrojtje, domethënë për azil, kur ekziston rreziku që, nëse ktheheni në vendin tuaj, t'ju vrasin, t'ju torturojnë ose të ushtrojnë mbi ju dhunë të rëndë. Nuk keni të drejtë të merrni strehim politik në Norvegji në qoftë se, në shtetin tuaj, ka për ju vende të sigurta ose mund t'ju mbrojnë autoritetet e vendit.

E drejta për mbrojtje përcaktohet nga marrëveshje ndërkombëtare të cilave Norvegjia është e detyruar t'iu përmbahet.

2. KUSH KA TË DREJTË PËR LEJE QËNDRIMI PËR ARSYE HUMANITARE?

Në qoftë se nuk keni të drejtë për strehim politik, autoritetet do të vlerësojnë a plotësoni kushtet për leje qëndrimi me arsye humanitare ose për shkak të lidhjeje të veçantë me Norvegjinë. Kjo njihet si përshtatshmëri qëndrimi për arsye humanitare.

Normalisht duhet të keni pasaportë për të fituar një leje të tillë qëndrimi. Mosparaqitja e një pasaporte tek autoritetet mund të sjellë refuzimin e kërkesës suaj ose dhënien e një lejeje të kufizuar qëndrimi që nuk iu jep mundësinë për qëndrim të përhershëm ose për imigrimin e familjes suaj bashkë me ju.

3. CILI SHTET DO TË SHQYRTOJË KËRKESËN TUAJ PËR AZIL?

Jo të gjithëve atyre që kërkojnë strehim politik në Norvegji iu shqyrtohet kërkesa po aty. Marrëveshja e Dublinit parashikon bashkëpunimin mes shteteve evropiane në mënyrë që kërkesa e një azilkërkuesi të merret në shqyrtim vetëm në një prej vendeve të mbuluara nga marrëveshja.

Kërkesa juaj do të mund të shqyrtohet nga një shtet tjetër pjesëmarrës në marrëveshjen e Dublinit nëse – në vendin në fjalë:

- ju janë marrë shenjat e gishtërinjve
- keni bërë kërkesë për azil
- keni vizë ose leje qëndrimi
- ka anëtarë të familjes suaj

Zakonisht nevojiten 2 deri në 6 muaj që autoritetet norvegjeze të hetojnë dhe vendosin nëse do të transferoheni në një shtet tjetër.

Nëse ju nevojiten informacione të mëtejshme, mund të merrni broshurën e posaçme lidhur me Marrëveshjen e Dublinit, në organizatën NOAS.

4. KUSH DO TA SHQYRTOJË NË NORVEGJI KËRKESËN TUAJ PËR AZIL?

Departamenti Norvegjez i Imigracioni (UDI) është pjesë e administratës publike norvegjeze. Punonjësit e departamentit do t'ju intervistojnë dhe do të vendosin nëse do t'ju lëshohet leja e qëndrimit. UDI shqyrton me kujdes të gjitha kërkesat duke e trajtuar siç duhet secilën prej tyre.



5. ÇFARË NDODH KUR BËNI KËRKESË PËR MBROJTJE?

Regjistroheni pranë policisë si azilkërkues

Në polici do t'ju fotografojnë dhe do t'ju merren shenjat e gishtërinjve. Do t'ju bëjnë pyetje mbi identitetin tuaj, mbi mënyrën se si keni ardhur në Norvegji dhe mbi arsyen për të cilën po kërkonti mbrojtje. UDI do të kërkojë të dijë prej jush përse jeni duke kërkuar mbrojtje e azil. Nëse keni me vete dokumente identifikimi, duhet t'i paraqisni gjatë regjistrimit.

Transferoheni në një qendër pritjeje

Pas regjistrimit do t'ju përcjellin në një qendër pritjeje të përkohshme. Do të qëndroni aty për disa ditë deri sa t'ju zhvendosin në një tjetër qendër të përkohshme ose në një qendër pritjeje normale. Punonjësit e qendrës do t'ju japin më tepër informacione mbi të drejtat dhe detyrimet tuaja.

Do t'ju bëhet kontrolli për tuberkuloz

Gjatë ditëve të para në qendrën e pritjes do t'ju bëhen analizat për të parë nëse jeni me tuberkuloz. Kjo është e detyrueshme për të gjithë. Duhet të informoni qendrën shëndetësore nëse keni ndonjë problem të rëndë shëndetësor që kërkon trajtim urgjent.

Organizata NOAS do t'ju japë informacione dhe udhëzime

Gjatë ditëve të para në qendrën e pritjes, do të merrni informacione nëpërmjet NOAS-it. NOAS-i është një organizatë jo-qeveritare për të drejtat e njeriut e cila përfaqëson azilkërkuesit në Norvegji. Detyra e saj në qendrën e pritjes është t'iu ofrojë informacione dhe udhëzime azilkërkuesve. Do të shihni një film informues lidhur me procedurat për azil dhe do të bisedoni me një anëtar të NOAS-it. Qëllimi i bisedës është përgatitja për intervistën në departamentin e imigracionit. Është e rëndësishme që të shfrytëzoni këtë bisedë për pyetje që mund t'iu kenë lindur mbi kërkesën për mbrojtje. Biseda do të bëhet në një gjuhë që jeni në gjendje ta kuptoni mirë.



Nëse ka të ngjarë që do të transferoheni në një shtet tjetër evropian në përputhje me Marrëveshjen e Dublinit, atëherë është e rëndësishme ta përmendni këtë për t'iu siguruar që informacionet që do t'iu jepen të jenë të sakta.

Punonjësit e NOAS-it janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e të dhënave tuaja.

Do të merreni në intervistë nga UDI

Intervista për azil është rasti më i rëndësishëm që ju jepet për të shpjeguar arsyen e kërkesës suaj për mbrojtje. Zakonisht kjo intervistë zgjat disa orë. Shpjegoni në mënyrë konkrete e të hollësishme çfarë keni përjetuar e nga se keni frikë nëse do t'ju duhej të ktheheshit në atdhe. Gjatë intervistës do të jetë i pranishëm një përkthyes. Ky do të jetë asnjans dhe i detyruar që të ruajë fshehtësinë e informacioneve tuaja. Nëse do ta keni të vështirë të kuptoni çfarë do të jetë duke u thënë, duhet të vini në dijeni menjëherë intervistuesin. Në përfundim të intervistës për azil, do të nënshkruani një relacion mbi çështjet për të cilat u fol gjatë intervistës. Relacioni do t'ju lexohet nga përkthyesi. Nëse dëshironi të ndryshoni diçka në relacion, duhet ta përmendni atë përpara se të nënshkruani.

Transferoheni në një qendër normale pritjeje ku do të jetoni ndërkohë që prisni përgjigje nga UDI

Banimi në qendrën e pritjes është falas. Nëse dëshironi, mund të jetoni në mënyrë të pavarur ndërkohë që prisni përgjigjen e UDI-t, por, në këtë rast nuk do të merrni ndihmë financiare. Nëse transferoheni, duhet të njoftoni qendrën e pritjes, e cila do të regjistrojë adresën tuaj të re. Regjistrimi i adresës ka shumë rëndësi për të bërë të mundur që të merrni përgjigjen e UDI-t.

Të reja të tjera

Nëse, pas intervistës për azil, do të viheni në dijeni për të reja të tjera me rëndësi për kërkesën për mbrojtje, duhet të njoftoni menjëherë UDI-n. Shpjegoni përse nuk i patët përmendur më parë këto informacione. Punonjësit e qendrës mund t'ju udhëzojnë se si kryhet kjo gjë.

Prisni përgjigjen e UDI-t

Shqyrtimi i kërkesës suaj për azil nga ana e UDI-t mund të zgjasë nga disa javë deri më shumë se një vit. Pritja për një kohë të gjatë mund të ndodhë sepse UDI duhet të hetojë nëse informacionet që keni dhënë janë të sakta. Gjithashtu, arsyeja mund të jetë që UDI është duke hetuar rrethanat në vendin tuaj, apo sepse shumë njerëz të tjerë janë duke pritur një përgjigje si ju.

Përgjigja që merrni nga UDI: leje qëndrimi ose refuzim kërkesë

Leje qëndrimi

Nëse ju jepet një leje qëndrimi, do t'ju ofrohet strehim në një komunë lokale. Informacione të mëtejshme do t'ju jepen në qendrën e pritjes.

Refuzim kërkesë

Nëse ju është refuzuar kërkesa, keni të drejtë të ankoheni. Do t'ju jepet ndihmë ligjore për kryerjen e ankesës, zakonisht pesë orë ndihmë. Ankesa duhet të bëhet brenda tri javëve. Gjatë shqyrtimit të kërkesës suaj mund të qëndroni në Norvegji, por jo nëse UDI beson që kërkesa është krejtësisht e pabazë.

Komisioni Norvegjez i Ankesave për Imigracionin (UNE)

Ankesa juaj do të merret në shqyrtim nga UNE-ja. Mund t'ju ftojë në takim ose t'ju kërkojnë paraqitjen e informacioneve shtesë.

Nëse kërkesa ju refuzohet, jeni të detyruar të ktheheni në vendin tuaj

Duhet të ktheheni në shtëpi brenda afatit të përcaktuar nga policia, zakonisht brenda dy javëve. Pas përfundimit të këtij afati nuk do të keni të drejtë ligjore për qëndrim në Norvegji. Nëse keni marrë refuzimin përfundimtar, kur p.sh. UNE-ja mbështet refuzimin e mbrojtjes nga ana e UDI-t, mund të vendosni të ktheheni me vullnet të lirë nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Imigracionit (IOM), ose të shoqëroheni jashtë vendit nga policia (kthim me forcë).

Kthimi vullnetar me ndihmën e IOM-it

Autoritetet norvegjeze do të organizojnë kthimin tuaj vullnetar në atdhe. Kthimi vullnetar nënkupton që bashkëpunoni për udhëtimin tuaj për në atdhe duke bërë një kërkesë për pranim, nëpërmjet programit norvegjez për kthim i quajtur Programi vullnetar për kthimin e asistuar (VARP).

Programi VARP është një bashkëpunim mes UDI-s dhe IOM-it, organizatat që merren me organizimin e udhëtimin tuaj për në atdhe. Nëse ktheheni vullnetarisht, qeveria e Norvegjisë paguan për kthimin tuaj.

Çdo person që nuk ka leje qëndrimi për në Norvegji mund të aplikojë për kthim vullnetar. Nëse kërkesa juaj për azil refuzohet, keni në dispozicion një kohë të kufizuar për t'u larguar nga Norvegjia. Nëse dëshironi të ktheheni vullnetarisht, duhet t'i dërgoni një kërkesë IOM-it



menjëherë pas refuzimit të kërkesës suaj për azil. Nëse kërkesa për kthim miratohet, IOM-i do t'ju udhëzojë dhe ndihmojë në marrjen e dokumenteve të udhëtimit si dhe do t'ju rezervojë biletat. Për të patur mundësinë e udhëtimit me ndihmën e IOM-it, duhet të keni pasaportë të vlefshme ose dokument tjetër udhëtimi të lëshuar nga autoritetet e vendit tuaj. Nëse nuk keni pasaportë të vlefshme ose dokument udhëtimi, IOM-i do t'ju ndihmojë të siguroni një të tillë nga ambasada/konsullata juaj më e afërt. Nëse dëshironi, IOM-i do t'ju ndihmojë gjithashtu gjatë udhëtimit dhe në çastin e mbërritjes në atdhe.

Informacione të tjera për kthimin vullnetar dhe për ndihmën në plotësimin e formularit të kërkesës mund të merren në qendrën e pritjes, pranë zyrës rajonale të UDI-t ose pranë IOM-it.

Kthimi me forcë

Nëse pas refuzimit përfundimtar nuk ktheheni vullnetarisht në shtëpi, menjëherë pas përfundimit të afatit të caktuar do të shoqëroheni jashtë vendit nga policia.

Duhet të paguani vetë për kthimin e detyruar . Nëse nuk keni mundësi të paguani biletën e fluturimit, atëherë kjo do të paguhet nga qeveria, por jeni i detyruar të ktheni shpenzimet. Nëse nuk paguani këto shpenzime, ka mundësi që më vonë t'ju refuzohet kërkesa për vizë hyrjeje për në Norvegji dhe për në vende të tjera të Evropës.

Nëse kryeni një vepër penale

Nëse kryeni një krim, kërkesa juaj për azil do të shqyrtohet jashtëzakonisht shpejt, që do të thotë që së shpejti mund t'ju jepet urdhri për t'u larguar nga Norvegjia. Gjithashtu, mund të dëboheni nga Norvegjia nëse kryeni një vepër të paligjshme, gjë që do të thotë që më vonë nuk do të mund të hyni në Norvegji ose në shumicën e vendeve evropiane.

6. KËSHILLA TË RËNDËSISHME PËR INTERVISTËN E AZILIT

- Shpjegoni mirë e në mënyrë të hollësishme arsyen e largimit nga atdheu dhe se çfarë ju frikëson nëse do të duhej të ktheheshit sërish aty.
- Përqendrohuni mbi atë që keni përjetuar dhe atë që do të ndodhte nëse do t'ju duhej të ktheheshit.
- Mundohuni të jeni sa më i saktë.
- Nëse me vete keni fëmijë me moshë më të vogël se 18 vjeç, shpjegoni gjendjen e tyre dhe atë që kanë përjetuar.
- Kërkojini intervistuesit t'ju shpjegojë çështjet që nuk kuptoni.
- Nëse keni dokumente me rëndësi për kërkesën tuaj për azil, duhet t'i merrni ato me vete në intervistë.
- Tregoni të vërtetën. Nëse thoni diçka të gënjeshtërt, kërkesa për azil mund t'ju refuzohet. Gjithashtu mund t'ju dëbojnë nga Norvegjia e, pra, më vonë, nuk do të keni mundësi të hyni në Norvegji ose në shumicën e vendeve evropiane.

Kërkesa për azil e grave

Femrat mund të jenë objekt formash tjera persekutimi, ndryshe nga meshkujt. Këto gjëra mund të jenë të rënda për t'u thënë, veçanërisht nëse bashkëbiseduesi është burrë. Nëse dëshironi, mund të bisedoni me një punonjëse femër të NOAS. Për këtë, bëjani të ditur NOAS-it dëshirën tuaj sa më shpejt pas shikimit të filmit informues.

Gjithashtu, mund të kërkonte një intervistuese apo përkthyes femër gjatë intervistës suaj me UDI-n. Mund ta shprehni këtë kërkesë gjatë bisedimeve me NOAS-in.

Keni me vete fëmijë nën moshën 18 vjeçare?

Gjendja e fëmijës është e rëndësishme në vlerësimin e pozicionit të azilkërkuarit. UDI do të dëshirojë të dijë nëse fëmija ka arsye të vetat për kërkim azili dhe të kuptojë mënyrën se si fëmija i sheh rrethanat e jetës së vet. Ka rëndësi që këtë t'ia tregoni UDI-t gjatë intervistës për azil.

UDI interviston fëmijë me moshë më të madhe se shtatë vjeç. Është e rëndësishme që fëmijës t'ju jepet mundësia të shpjegojë me fjalët e veta çfarë ka përjetuar. Ndonjëherë ata i përjetojnë vështirësitë në mënyrë më të fortë sesa të rriturit. UDI nuk interviston asnjëherë fëmijë nëse ata vetë nuk kanë dëshirë të intervistohen.

7. DETYRIMET DHE TË DREJTAT TUAJA SI AZILKËRKUES

Jeni i detyruar të jepni ndihmë për qartësimin e identitetit tuaj

Është e rëndësishme që autoritetet e Norvegjisë të dinë kush jeni. Për këtë arsye ka

rëndësi të paraqisni dokumente të cilat vërtetojnë identitetin tuaj. Nëse jeni i persekutuar nga autoritetet e atdheut tuaj, autoritetet norvegjeze nuk do t'ju kërkojnë t'i kontaktoni ato për të marrë dokumente identifikimi.

Nëse autoritetet norvegjeze kanë dyshime mbi identitetin tuaj, ka rrezik që:

- të mos ju besojnë
- t'ju zvogëlohen mundësitë për marrjen e lejes së qëndrimit
- të humbisni të drejtat që ndryshe do t'ju ofroreshin
- të merrni leje të kufizuar qëndrimi

Jeni i detyruar të paraqisni informacione të sakta

Duke qenë azilkërkues duhet të shpjegoni arsyen e kërkesës për mbrojtje. Për këtë qëllim, duhet të bëni gjithçka është e mundur për të paraqitur dokumentacionin e nevojshëm. Pavarësisht nga çfarë keni dëgjuar përpara se të bëni kërkesën për mbrojtje, është me rëndësi të madhe t'iu shpjegoni autoriteteve norvegjeze arsyet e sakta të kërkesës së azilit. Dhënia e informacioneve të pasakta përbën vepër penale që mund të sjellë dëbimin tuaj nga vendi.

Keni të drejtë të punoni gjatë kohës që kërkonti azil

Ndërkohë që prisni shqyrtimin e kërkesës për azil, nëqoftëse jeni në gjendje të vërtetoni identitetin tuaj dhe nëse rasti juaj nuk është duke u hetuar sipas Marrëveshjes së Dublinit, mund të merrni leje për punë. Leja për punë është e vlefshme deri në gjashtë muaj por mund t'i zgjatet afati.

Keni të drejtë për trajtim mjekësor

Keni të drejtë të përfitonit trajtimin mjekësor që ju nevojitet për sa kohë jeni në pritje të shqyrtimit të kërkesës për azil. Trajtimi mjekësor për fëmijët nën moshën 12 vjeçare është falas. Zakonisht, në Norvegji, gjithkush duhet të kontribuojë për trajtimin e vet mjekësor. Nëse keni nevojë për ndihmën e një psikologu, mund të bëni kërkesë pranë UDI-it që ky të paguajë shpenzimet. Lidhuni me punonjësit e qendrës së pritjes për informacione shtesë. Bëjani të ditur UDI-t nëse keni probleme të rënda shëndetësore.

Mund ta tërhiqni kërkesën për azil

Kërkesa për azil mund të tërhiqet në çdo kohë. Më pas do të keni mundësinë të bëni kërkesë pranë organizatës IOM për ndihmë për të udhëtuar në atdhe.

8. DETYRIMI PËR MBAJTJEN E SEKRETTIT PROFESIONAL

Policia, UDI, UNE-ja, përkthyesi, avokati, personeli shëndetësor dhe NOAS-i kanë për detyrë mbajtjen e sekretit profesional. Kjo do të thotë që ata nuk mund t'ju japin autoriteteve të vendit tuaj informacione mbi kërkesën tuaj për azil. Gjithashtu, nuk mund të informojnë për të dhënat tuaja persona të cilët nuk janë duke punuar me kërkesën tuaj për azil. Shkelja e detyrimit për ruajtjen e fshehtësisë përbën vepër penale. Për këtë arsye, nuk duhet të trembeni që të shpjegoni në hollësi përse kërkonti mbrojtje.

ADRESAT

NJËSIA E POLICISË PËR IMIGRACIONIN (POLITIETS UTLENDINGSENHET)

Policia regjistron azilkërkuesit e posambërritur.

Gjithashtu, ajo riatdheson azilkërkuesit të cilët nuk largohen vullnetarisht nga Norvegjia pas refuzimit të kërkesës së tyre për azil.

Adresa postare: Postboks 8102 Dep., 0032 Oslo, Norway

Adresa për takime: Christian Kroghs gate 32, Oslo

Telefon: +47 22 34 24 00, faks: +47 22 34 24 80

E-mail: pu@politiet.no

DEPARTAMENTI NORVEGJEZ PËR IMIGRACIONIN (UDI)

është një institucion qeveritar detyrat e të cilit përfshijnë shqyrtimin e kërkesave për azil, të vizave, të çështjeve të nënshtetësisë dhe të ribashkimit të familjeve. UDI gjithashtu është përgjegjës për qendrat e pritjes.

Adresa postare: Postboks 8108 Dep., 0032 Oslo, Norway

Adresa për takime: Hausmannsgate 21, Oslo

Telefon: +47 23 35 15 00, faks: +47 23 35 15 01

Faqja në internet: www.udi.no, E-mail: ots@udi.no

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E IMIGRACIONIT (IOM)

Informacione për kthim vullnetar të asistuar

Adresa postare: Postboks 8927 Youngstorget, 0028 Oslo

Adresa për takime: Storgata 10a, kati 2^{te}, Oslo

Telefon: +47 23 10 53 20, faks: +47 23 10 53 21

E-mail: osloreturn@iom.int

Oraret e punës: Ditë jave: 10:00 – 15:00, Fund jave: mbyllur

KOMISIONI NORVEGJEZ I ANKESAVE PËR IMIGRACIONIN (UTLENDINGSNEMNDA – UNE)

është një organ administrativ me fuqi pothuaj gjyqësore për shqyrtimin e ankesave ndaj refuzimeve të UDI-t.

Adresa postare: Postboks 8165 Dep., 0034 Oslo, Noway

Adresa për takime: Stenersgate 1 B/C, Oslo

Telefon: +47 21 08 50 00, faks: +47 21 08 50 01

Faqja internet: www.une.no, E-mail: postmottak@une.no

KRYQI I KUQ NORVEGJEZ (NORGES RØDE KORS),

shërbime gjetjeje, ndihmon në rikrijimin e kontakteve mes anëtarëve të humbur të familjeve në luftë, konflikte ose katastrofa.

Kryqi i Kuq nuk ua jep të dhënat tuaja UDI-t apo të tjerëve. Shërbimi është falas.

Adresa postare: Postboks 1 – Grønland, 0133 Oslo

Adresa për takime: Hausmannsgt. 7, Oslo

Telefon: +47 22 05 40 00

Faqja internet: www.rodekors.no, E-mail: tracing@redcross.no

NOAS është një organizatë jo-qeveritare për të drejtat e njeriut që iu ofron informacione dhe ndihmë ligjore azilkërkuesve.

Broshura përmban informacione të rëndësishme për azilkërkuesit që kërkojnë mbrojtje në Norvegji.



Organizata Norvegjeze për Azilkërkuesit (NOAS)

Adresa për takime: Torggata 22, 0183 Oslo, Norway

Adresa postare: P.O. Box 8893 Youngstorget, NO-0028 Oslo, Norway

Tel.: +47 22 36 56 60, Faks: +47 22 36 56 61

Faqja internet: www.noas.org, E-mail: noas@noas.org